



Titulli i Trajnimit: “AFTËSITË KREATIVE DHE INOVATIVE“

Lloji i Kursit: Edukimi i vazhdueshëm në fushën e kreativitetit dhe inovacionit

Është kënaqësi t'ju ftojme të ndjekni një kurs ekskluziv në temën "Aftësitë e Kreativitetit dhe Inovacionit". Kemi zgjedhur këtë temë, sepse besojmë se aftësitë kreative dhe inovative janë ndër faktorët më të rëndësishëm të suksesit për kompanitë në mjedisin e sotëm të biznesit.

Ne nuk e shohim kreativitetin dhe trajnimin e inovacionit si një ngjarje, por si një proces i vazhdueshëm për të përmirësuar aftësitë, njohuritë dhe rezultatet në aspektin e procesit dhe përmirësimit të produktit dhe zhvillimit. Sistemi ynë i trajnimit tregon ndryshimin e vërtetë të sjelljes dhe hap potencialet kreative dhe inovative në kompaninë tuaj bazuar në teknikat më moderne për përmirësimin e aftësive kreative.

Objektivat e Trajimit:

Qëllimi i këtij moduli është pajisja e pjesëmarrësve me njohuri për të zbatuar Metodologjinë Kreative të Zgjidhjes së Problemeve, e cila do t'i ndihmojë ata të:

- a) *Te identifikojnë një problem praktik (një kontekst biznesi të dhënë ose edhe ndonjë fushë sipas zgjedhjes suaj),*
- b) *Gjenerimi i ideve kreative për adresimin dhe / ose zgjidhjen e këtij problemi,*
- c) *Vlerësimi i ideve tuaja dhe përzgjedhja e një ideje ose grupi idesh të përshtatshme,*
- d) *Arsyetimin e vlerës praktike për idenë(të) e zgjedhur,*
- e) *Zhvillimi i një qasje kreative dhe efektive për zbatimin e idesë.*
- f) *Të justifikojë potencialin inovator të një zgjidhjeje të gjeneruar*
- g) *Demonstrimi i të kuptuarit të menaxhimit të suksesshëm të projektit në kushtet e pasigurisë dhe rrezikut.*

¹ Projekti EUFORIA është një projekt i financuar nga BE, që bashkon pesë universitete të BE-së, gjashtë universitete kosovare, OEK, Gratë në Biznes dhe katër kompani kosovare. Qëllimi është të përmirësojë lidhjet mes universiteteve dhe ndërmarrjeve në Kosovë dhe të përmirësojë punësueshmërinë e të diplomuarve universitarë. Projekti siguron mbështetje të pjesshme për këtë kurs trajnimi. Kjo reflektohet në çmimin e saj më të ulët se çmimi normal.

Ofrimi i njohurive mbi temat e mëposhtme:

Temat që do të shtjellohen gjatë këtij trajnimi janë:

- Si të inkurajojmë dhe zhvillojmë kreativitetin dhe inovacionin në një kompani?
- Llojet e krijimtarisë dhe inovacionit – Modelet
- Krijimi dhe zgjidhja e problemeve (CPS)
- Identifikimi i Fazave të Modelit të Inovacionit (Gjetja e Fakteve, Gjetja e Problemeve, Inovacioni, Gjenerimi i Idesë, Shqyrtimi dhe Vlerësimi)
- Planifikimi i Projektit - Implementimi Faza e CPS
- Suksesi dhe çfarë mund të shkojë keq

Pritet që pjesëmarrësit të marrin shënime dhe të jenë proaktivë. Pjesëmarrësit do të pajisen me një katalog trajnimi që do t'i udhëheqë më tutje drejt rezultateve më të mira të teknikës së kreativitetit pas trajnimit.

Kujt i dedikohet ky kurs?

Ky trajnim është dizajnuar veçanërisht për stafin menaxhues në të gjitha nivelet, menaxherët e prodhimit, stafin e marketingut, si dhe për të gjithë personat të cilët janë të interesuar dhe të gatshëm të zgjerojnë aftësitë e tyre inovative për përmirësimin e performancës. Në fund të fundit, pavarësisht nga profesioni ynë, ne jemi të gjithë të ekspozuar ndaj nevojës për aftësi krijuese të zgjidhjes së problemeve dhe duhet të dimë se si të aplikojmë aftësitë e kreativitetit në mënyrë që të bëhemi më efikas dhe të fitojmë përparësi konkurruese ndaj konkurrentëve. Ky kurs është i dobishëm për të gjitha kompanitë pavarësisht nga sektori i operacioneve dhe madhësisë - të gjitha kanë nevojë për krijimtari.

Kohëzgjatja:

Trajnimi zgjat 2 ditë, nga data 13-14.6.2018 duke filluar nga ora 10:00 deri 16:00.

Vendi:

Oda Ekonomike e Kosovës, salla A.

Çmimi:

Çmimi total i trajnimit është 99€. Anetarët e OEK-ut përfitojnë zbritje nga 10% deri në 30% varësisht nga pakoja në të cilën janë të anëtarësuar.

Trajnerët/Ekspertët:

1. Prof. Assoc. Dr. Besnik Krasniqi ekspert i krijimtarisë dhe inovacionit, me mbi 25 vjet eksperiencë në sipërmarrjen dhe inovacionin me një gamë të gjerë eksperiencash në akademi, në sektorin privat dhe si konsulent. Dr. Krasniqi është Profesor i asociuar në Fakultetin Ekonomik të Universitetit të Prishtinës dhe gjithashtu një konsulent i certifikuar menaxhimi. Ai është drejtor i Qendrës për Mbështetje të Biznesit në Kosovë dhe ka hartuar dhe shpërndarë këshillim biznesi dhe konsulencë për fillimin e punës në fushën e inovacionit të biznesit të vogël.
2. Dr. Fisnik Reçica, hulumtues në Institutin Riinvest dhe ligjërues në Kolegjin Riinvest, me eksperiencë të madhe në kërkime mbi inovacionin dhe si drejtues i kurseve/trajnimeve për inovacionin.

Si te aplikoni?

Ju mund të aplikoni në menyrë elektronike në e-mail edlira.hetemaj@oek-kcc.org gjithashtu edhe drejtpërdrejtë në zyret e Odës Ekonomike të Kosovës. Për më shumë informata ju mund të na kontaktoni çdo ditë pune nga ora 08:00 deri 16:00, në numrat e telefonit : 038 224 299 ose 045 639 444.